



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr.1374/5 Prot

Tiranë më 17.05.2018

## VENDIM

**Nr. 14, Datë 17.05.2018**

***“Mbi përcaktimin e kategorive të studentëve që plotësojnë kriteret për reduktimin në masën 50%, të tarifës së shkollimit në programet të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018”***

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, neni 38, shkresës MASR-it nr. 2921, datë 19.03.2018, në kuadrin e politikave sociale që institucioni ndjek, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 17.05.2018;

## VENDOSI:

1. Studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018, të cilët i përkasin kategorive të mëposhtme përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50%:
  - a. Personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
  - b. Invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
  - c. Invalidët ;
  - d. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
  - e. Jetimët;
  - f. Romët;
  - g. Ballkano- egjiptianë;
  - h. Personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta dhe familja, në këtë rast përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
  - i. Ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
  - j. Fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të F.A që kanë humbur të jetën në krye apo për shkak të detyrës.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

**KRYETARI**

**PROF.DR.MYNYR KONI**